Rregullorja e lojës promocionale “Llotaria iuteMarket Nëntor 2026”

Hartuar në përputhje me Ligjin “Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë”, nr. 155/2015, dhe kërkesat e Vendimit nr. 196, datë 15/03/2017, të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Mënyrave, Formave, Kritereve dhe Rregullave për Organizimin e Lojërave të Fatit Promocionale”.

Kjo rregullore (“**Rregullorja**”) ka për qëllim të vendosë rregulla të qarta për organizimin dhe zhvillimin e Lojës Promocionale “**Llotaria iuteMarket Nëntor 2026**”, organizuar nga IuteCredit Albania sh.a., si dhe për pjesëmarrësit në të. Ajo është e vlefshme për kohëzgjatjen gjatë së cilës do të zhvillohet Loja Promocionale.

“**Llotaria iuteMarket Nëntor 2026**” organizohet dhe zhvillohet nga IuteCredit Albania sh.a., me seli në adresën “Rruga Andon Zako Çajupi, Tiranë, Shqipëri”, me NIPT L42011023U, e regjistruar si subjekt tatimpagues në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Tiranë, me administrator z. Akan Ajdini.

Territori në të cilin do të zhvillohet Loja Promocionale do të jetë e gjithë Shqipëria, për blerje në iuteMarket**,** *që është platforma e blerjeve brenda aplikacionit Myiute, ku mund të blihen produkte me këste, me fondet e klientit që ka gjendje në llogarinë e tij në Myiute, me Pike Plus ose Cash on Delivery.*

Myiute është aplikacioni zyrtar i iute Albania, i cili funksionon si një platformë digjitale për administrimin e financave personale dhe aksesin në shërbimet financiare të ofruara nga kompania. Aplikacioni u mundëson përdoruesve të aksesojnë dhe të përdorin shërbime të ndryshme financiare në distancë, në çdo kohë.

Nëpërmjet Myiute, klientët mund të aplikojnë për kredi konsumatore, të përdorin Portofolin Digjital për kryerjen e pagesave dhe transfertave ndërmjet përdoruesve (P2P), të kryejnë pagesa faturash, si dhe të shtojnë ose të tërheqin fonde nëpërmjet rrjetit të ATM-ve dhe agjentëve iute.

Aplikacioni përfshin gjithashtu platformën iuteMarket, e cila u mundëson klientëve të blejnë produkte të ndryshme duke përdorur mënyra të ndryshme pagese, përfshirë financimin me këste, fondet personale të disponueshme në llogarinë Myiute dhe pagesën në momentin e dorëzimit të produktit (Cash on Delivery).

Në këtë mënyrë, Myiute shërben si një platformë e integruar që ndërthur shërbimet e financimit, portofolin digjital dhe blerjet online, duke u mundësuar klientëve akses të centralizuar në shërbimet e iute Albania.

Me anë të kësaj Lojë Promocionale, IuteCredit Albania sh.a. ka për qëllim të promovojë pagesat nëpërmjet Myiute.

Neni 1. - Lloji i Lojës Promocionale, çmimet dhe kushtet e pjesëmarrjes

Loja Promocionale është konceptuar si një lojë fati promocionale, në të cilën do të marrin pjesë të gjithë klientët që bëjnë një blerje produkti me vlerë minimale 10,000 lekë në iuteMarket, që është platforma e blerjeve brenda aplikacionit Myiute, ku mund të blihen produkte me këste, me fondet

e klientit që ka gjendje në llogarinë e tij në Myiute, me Pike Plus ose Cash on Delivery, **nga 10 Nëntori deri më 10 Dhjetor 2026**.

Blerjet në platformën iuteMarket mund të kryhen nëpërmjet mënyrave të mëposhtme të pagesës:

1. Kredi për blerjen e produkteve

Klientët mund të financojnë blerjen e produkteve me këste, pa përfituar para në dorë. Ky financim përdoret për blerjen e produkteve të ndryshme, si pajisje elektroshtëpiake, produkte elektronike, shërbime etj., të ofruara nga dyqanet partnere të iute dhe platforma iuteMarket.

2. Pagesa me fondet personale të klientit në llogarinë Myiute

Klientët mund të kryejnë blerje në iuteMarket duke përdorur fondet personale të disponueshme në llogarinë e tyre në aplikacionin Myiute. Këto fonde mund të shtohen nëpërmjet ATM-ve iute, transfertave bankare, agjentëve iute ose transfertave nga përdorues të tjerë të aplikacionit Myiute, nëpërmjet funksionalitetit Peer-to-Peer (P2P).

3. Nëpërmjet Pikëve Plus

Klientët mund të përfitojnë Pikë Plus nga iutePlus i cili është program besnikërie i krijuar për të shpërblyer klientët sa herë që përdorin shërbimet e kredisë ose Portofolin Digjital Myiute.

Duke kryer aktivitete të ndryshme, si shlyerja në kohë e kësteve, marrja e sigurimit të kredisë, përdorimi i ATM-ve iute, aktivizimi i Portofolit Digjital Myiute, kryerja e transaksioneve të para apo të përsëritura në funksionet e portofolit digjital, si dhe pjesëmarrja në fushata speciale, klientët grumbullojnë Pikë Plus si shpërblim për besnikërinë e tyre.Pikët e grumbulluara mund të përdoren për të kryer pagesa te partnerët iute apo iuteMarket. 1 Pikë Plus = 1 Lek.

4. Pagesa në dorëzim (Cash on Delivery)

Klientët mund të zgjedhin të kryejnë pagesën në momentin e dorëzimit të produktit. Në këtë rast, pagesa bëhet drejtpërdrejt te korrieri, në momentin e marrjes së porosisë.

Cmimet	Kusht për pjesëmarrje
16 çmime specifikuar si më poshtë: • **1 (një) iPhone 18 Pro Max me vlerë totale 139,000 lekë, (përshirë dhe TVSH);** • **5 (pesë) kupona blerjeje në iuteMarket me vlerë 10,000 lekë (dhjetë mijë lekë), pa TVSH.** • **10 (dhjetë) kupona blerjeje në iuteMarket me vlerë 5,000 lekë (pesë mijë lekë), pa TVSH.**	Kualifikohen të gjithë klientët që kanë kryer një blerje produkti në iuteMarket me këste, ose me fondet e tyre që kanë gjendje në llogarinë e tyre në Myiute, ose me Pike Plus ose Cash on Delivery, *me vlerë minimale 10,000 lekë e sipër gjatë periudhës 01 – 30.11.2026*

Neni 2. Kohëzgjatja e lojës promocionale

Aplikimet për lojën promocionale do të jenë të vlefshme përgjatë periudhës **10 nëntor deri më 10 dhjetor 2026**.

Neni 3. Pritshmëritë për pjesëmarrje në Lojën Promocionale

Për Lojën Promocionale "**Llotaria iuteMarket Nëntor 2026**" pritet të marrin pjesë në lojë përafërsisht 3,000 klientë.

Neni 4. Regjistrimi në Lojën Promocionale

Çdo klient që plotëson kushtet e pjesëmarrjes në lojë sipas nenit 1 më sipër, automatikisht bëhet pjesë e Lojës Promocionale, pa kosto shtesë.

Çdo klient mund të refuzojë të përfshihet në lojë, me anë të një kërkese drejtuar IuteCredit Albania sh.a. Në rast të kërkesave të klientëve për të mos u përfshirë në këtë Lojë Promocionale, IuteCredit Albania sh.a. nuk do t'i përfshijë ata në përzgjedhjen që bëhet për shpalljen e fituesve.

Në të kundërt, klientët prezumohen se kanë dhënë miratimin e tyre për përfshirjen në këtë Lojë Promocionale, duke pranuar automatikisht rregullat dhe mekanizmin e Lojës Promocionale.

Neni 5. Përzgjedhja e fituesve

Fituesit do të përzgjidhen **në datën 11 dhjetor 2026, në orën 10:30 a.m., pranë zyrave qendrore të IuteCredit Albania sh.a.**, në adresën "Rruga Andon Zako Çajupi, Nd. 3, H.2, Tiranë, Shqipëri". Fituesit do të njoftohen nëpërmjet telefonatës në numrin e telefonit të deklaruar përkatësisht në aplikim.

Metodika e përzgjedhjes së fituesve do të jetë formula *Random* në Excel. Procesi do të protokollohet në përputhje me procedurën dhe rregulloret në fuqi.

Neni 6. Njoftimi i fituesit

Fituesi do të njoftohet me anë të një telefonate nga Shërbimi i Kujdesit ndaj Klientit të Iute. Për të përfituar çmimin, personi i zgjedhur duhet t'i përgjigjet thirrjes telefonike.

Neni 7. Regjistrimi i fituesit

Fituesit e përzgjedhur nga sistemi dhe të njoftuar me anë të telefonatës nga Shërbimi i Kujdesit ndaj Klientit të Iute do të përfitojnë një nga çmimet pjesë e këtij shorteu, të specifikuara në nenin 1.

Në rast se klienti nuk i përgjigjet telefonatës së bërë gjatë shorteut, përkatësisht në datën **11 dhjetor** (çdo fitues do të telefonohet deri në 3 herë), apo për ndonjë arsye tjetër nuk kualifikohet si fitues (sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje), atëherë fitues do të përzgjidhet referenca zëvendësuese. Për këtë arsye, do të përzgjidhen edhe 2 (dy) referenca rezervë, në rast se klienti fitues nuk do t'i përgjigjet telefonatës sipas parashikimeve në këtë nen, të cilat do të përdoren si fitues zëvendësues.

Neni 8. Rastet kur fituesi i përzgjedhur gjatë shorteut nuk kualifikohet

Nëpërmjet kësaj rregulloreje të lojës, IuteCredit Albania sh.a. përcakton se do të përjashtohen nga kategoria "fitues" dhe nuk do të kualifikohen si të tillë për të tërhequr "çmimin" në rastet si vijon:

1. Fituesi nuk u përgjigjet 3 (tri) telefonatave të njëpasnjëshme të bëra gjatë shorteut njoftues për shpalljen fitues.
2. Fituesi nuk paraqitet për tërheqjen e çmimit brenda afatit 1-mujor nga data e njoftimit.
3. Fituesi refuzon çmimin.
4. Fituesi nuk është i pajisur me dokument të vlefshëm identifikimi në momentin e tërheqjes së çmimit.
5. Fituesi refuzon të nënshkruajë procesverbalin e tërheqjes së çmimit.

Neni 9. Përjashtimi nga përgjegjësia

IuteCredit Albania sh.a. nuk do të jetë përgjegjëse për fituesit të cilët nuk disponojnë dokumentet e nevojshme dhe/ose nuk regjistrohen sipas procedurës së regjistrimit në nenin "Regjistrimi i fituesit" më sipër; nuk u përgjigjen 3 telefonatave të njëpasnjëshme të bëra gjatë shorteut njoftues për shpalljen fitues; nuk paraqiten për tërheqjen e çmimit brenda afatit 1-mujor nga data e njoftimit; refuzojnë çmimin; nuk janë të pajisur me dokument të vlefshëm identifikimi në momentin e tërheqjes së çmimit; ose refuzojnë të nënshkruajnë procesverbalin e tërheqjes së çmimit.

Çmimi nuk mund të tërhiqet nga palë të treta të cilat nuk kanë fituar dhe as nuk mund të konvertohet në rimbursim me para në dorë.

Neni 10. Ruajtja e dokumentacionit

I gjithë dokumentacioni i Lojës Promocionale, qoftë elektronik dhe/ose fizik (mënyra e zhvillimit, numri i pjesëmarrësve, çmimet e shpërndara, emrat dhe adresat e fituesve), do të ruhet për një periudhë jo më pak se 6 (gjashtë) vjet.

Neni 11. Të ndryshme

IuteCredit Albania sh.a. rezervon të drejtën për të ndryshuar një apo disa nga kushtet e kësaj Lojë Promocionale, duke marrë miratimin paraprak të institucioneve përkatëse.

IuteCredit Albania sh.a. rezervon të drejtën për të publikuar informacion në lidhje me fituesit. Në rast se kjo nuk është e pranueshme, fituesit duhet të njoftojnë paraprakisht IuteCredit Albania sh.a. në momentin kur lajmërohen se janë fitues.

Duke marrë pjesë në Lojë dhe/ose duke u shpallur fitues, pjesëmarrësit pranojnë të jenë pjesë e aktiviteteve promocionale të organizuara nga IuteCredit Albania sh.a. dhe që emri dhe imazhi i tyre të shfaqen dhe të publikohen në kuadrin e fushatave aktuale dhe të ardhshme, në faqet zyrtare të internetit të Iute dhe në rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe LinkedIn.

Për këtë qëllim, IuteCredit Albania sh.a. siguron deklaratën e dhënies së pëlqimit me shkrim të fituesve, sipas legjislacionit në fuqi.

Rregullorja e Lojës Promocionale do të publikohet në faqen e internetit të Iute, iute.al, në momentin e shpalljes së lojës.

Informacioni mbi Lojën mund të merret gjithashtu duke telefonuar në Kujdesin e Klientit të Iute, në numrin zyrtar 044505060.

Konsiderohet e mirëqenë që të gjithë pjesëmarrësit në këtë Lojë Promocionale të kenë lexuar dhe pranuar kushtet e mësipërme.

Për IuteCredit Albania sh.a.

Me respekt,

_____

Akan Ajdini
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv